



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDIM

NR. 19, DATË 21 / 11 /2024

PËR

**SHTYRJEN E AFATIT TË STATUSIT “INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK
PROCEDURË E ASISTUAR” PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT
“BANYAN TREE HOTEL - RESORT” ME SUBJEKT APLIKUES DAST SH.A., ME
NUIS K81401501G**

Në mbështetje të Nenit 9, nenit 18, dhe nenit 21 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreu II, pika 8 të VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, si dhe bazuar në Vendimin e Komitetit të Investimeve Strategjike Nr. 1/5, datë 29.03.2021 “Për miratimin e Statusit “Investim/Investitor strategjik procedurë e asistuar” për projektin e investimit me potencial strategjik “Banyan Tree Hotel - Resort” Komiteti i Investimeve Strategjike, me propozim të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA),

VLERËSOI:

- Komiteti i Investimeve Strategjike (KIS) me Vendimin Nr. 1/5, datë 29.03.2021, ka vendosur miratimin e statusit “Investim/Investitor strategjik procedurë e asistuar” për projektin e investimit me potencial strategjik “Banyan Tree Hotel - Resort” propozuar nga subjekti "Dast" sh.a. NUIS K81401501G, për realizimin e një investimi kompleks turistik, mes zonës së Drimadhës dhe Palasës Bashkia Himarë sipas gjurmës në hartën ilustruese bashkëlidhur këtij vendimi.
- Statusi “Investim/Investitor strategjik procedurë e asistuar” i dha projektit të investimit “Banyan Tree Hotel Resort”, për një periudhë 3 (tre) vjeçare, përveç afatit

të lejimit të përdorimit të brigjeve të detit dhe të zonës përkatëse së plazhit, të cilat do të vendoseshin me Vendim të Këshillit të Ministrave.

- Projekti parashikonte realizimin e një resorti me disa kate, me taraca, me kapacitet 184 dhoma (standarde, dupleks, suita dhe vila), si dhe do të ofrojë restorante, bare, pishina, SPA, palestër, salla konferencash, zona të dedikuara për fëmijët, parking dhe shumë mjedise të tjera çlodhëse e rekreative që do të plotësojnë të gjitha standardet në fuqi për certifikimin si “Hotel me 5 yje”.
- Në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike, masat mbështetëse që iu miratuan projektit me potencial strategjik ndër të tjera përfshinin:
 - Kryerje e procedurave me prioritet dhe brenda afateve të përsheptuara, në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike;
 - Asistencë në lidhje me dhënien e lejeve, licencave dhe autorizimeve të nevojshme për realizimin e projektit, në përputhje me afatet e parashikuara sipas legjislacionit të investimeve strategjike ;
 - Konsolidimi i të tokës;
 - Infrastrukturë mbështetëse në bazë të legjislacioneve sektoriale.
 - Miratim në parim të lejimit të përdorimit të brigjeve të detit si dhe zonën përkatëse të plazhit përballë kompleksit, por në asnjë rast për një afat më të gjatë se 30 (tridhjetë) vjet. Miratimi përfundimtar, koordinatat e sakta si dhe tarifa e përdorimit të brigjeve të detit 4 dhe të zonës përkatëse së plazhit në funksion të realizimit të projektit investues strategjik do të përcaktohen nëpërmjet një Vendimi të Këshillit të Ministrave, sipas parashtrimeve të hartës në Aneksin 1 të dokumentacionit që ka dorëzuar subjekti për aplikim.

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDOSI:

1. Shtyrjen e afatit të Statusit “Investim/Investitor Strategjik Procedurë e Asistuar” për projektin e investimit strategjik “Banyan Tree Hotel - Resort”, i cili do të realizohet nga subjekti "Dast" sh.a. NUIS K81401501G për një periudhë 2 (dy) vjeçare.

2. Në rast se përgjatë zhvillimit dhe zbatimit të projektit investues strategjik “Banyan Tree Hotel - Resort” konstatohen të dhëna të pavërteta, të rreme apo ndryshime të të dhënave të dala rishtazi, mbi bazën e të cilave nuk do të ishte vendosur për miratimin e statusit strategjik të këtij projekti me procedurën e veçantë, Komiteti i Investimeve Strategjike ka të drejtë të revokojë vendimin për dhënien e statusit strategjik.
3. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike, në asnjë rast nuk do të konsiderohet investim, qoftë sipas kuadrit vendas ashtu edhe atij ndërkombëtar, në fuqi në Republikën e Shqipërisë, duke qenë se miraton në parim realizimin e një projekti investimi, materializimi i të cilit do të bazohet në përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve që parashikojnë legjislacionet sektoriale në fuqi.
4. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike dhe i njoftohet investitorit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE
KRYEMINISTËR**

EDI RAMA

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
BELINDA BALLUKU**

MINISTËR I EKONOMISË KULTURËS DHE INOVACIONIT

BLENDI GONXHJA

MINISTËR I FINANCAVE

PETRIT MALAJ

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

ANILA DENAJ

AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT

ODISE MOÇKA

SEKRETARIATI TEKNIK I KIS

LAURA PLAKU (SARO)